



Prishtinë: 29.03.2018  
Kodi i ZRRE-së: V\_954\_2018

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_1563\_04\_17**;
- Ankesa e KESCO-së e datës **09.06.2017**.

### në seancën e mbajtur më datë 29.03.2018, nxori këtë:

#### V E N D I M

- I **REFUZOHET** ankesa e KESCO-së ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin J.K, Rr: Agim Çela, pn, Komuna e Prishtinës, me shifër të konsumatorit **DPR - 90043561** si e pa bazuar.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK\_V\_1563\_04\_17 i datës 27.04.2017.

#### A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 09.06.2017 ka pranuar ankesën e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së, i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkallës së parë për këto shkaqe: Përfaqësuesi i KESCO-së, në ankesë ka theksuar se njehsori elektrik nr. 35257381 është ndërruar me datë 14.01.2014 dhe se i njëjti është dërguar në qendrën e kalibrimit për shqyrtimin e saktësisë së matjes dhe kontrollim detal, pra është ndërruar 48 ditë kalendarike pas procesverbalit të datës 28.11.2013 si dhe ka potencuar se edhe po të ndërrohej njehsori elektrik me datë 28.11.2013 kjo nuk e amnistion konsumatorin nga faturimi i energjisë që nuk është regjistruar për shkak të djegies së fazave, bazuar në nenin 4.11.1 të Kodit të matjes së OSSH-së. Në ankesë theksohet se KESCO në këtë rast do të duhej që të bëjë anulimin e korigjimit të datës 16.01.2015 i cili i është ngarkuar konsumatorit për periudhën 6 mujore përpara ndërrimit dhe të ngarkoj konsumatorin për periudhën 6 mujore përparat procesit të datës 27.11.2013, pasi që me datë 27.11.2013 janë shqyçur dy fazat kontestuese e e cila nuk është kërkuar nga DMK.

Bazuar në këtë KESCO kërkon nga Bordi që të pezulloi vendimin e DMK/ZRRE\_V\_1563\_05\_17, në lidhje me shifrën **DPR - 90043561** si të pabazuar.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 29.03.2018 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për



Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejt dhe i bazuar në prova konkrete.

Lidhur me pretendimet e përfaqësuesit të KESCO-së, se korrigjimi i datës 16.01.2015 është në përputhshmëri me dispozita ligjore të rregullave në fuqi, për Bordin pretendimet të tilla janë vlerësuar si të paqëndrueshme për faktin se ka mos përputhje të mëdha në mes të procesverbaleve si dhe evidentimeve të gjendjes faktike tek pika matëse duke mos respektuar procedurat në fuqi për marrjen e të gjitha masave me qëllim që konsumatorit t'i bëhet regjistrimi i saktë i energjisë së shpenzuar.

Bordi i ZRRE ka analizuar procesverbalin e inspektimit nr. 0491189 i datës 27.11.2013 në të cilin është evidentuar nga ekipi i KEDS-it se: njehsori elektrik ka vulat distributive, hyrjet daljet janë në rregull, urat e tensionit janë në rregull, në shikim vizual njehsori duket në rregull si dhe i njëjti se bashku me KPO vulozet prapë. Pas përfundimit të të gjeturave në procesverbal është shtuar edhe se fazat L2 dhe L3 nuk bëjnë matje si dhe kanë bërë shkyçjen e daljeve L2 dhe L3 si dhe që njehsori duhet të shkojë në kalibrim. Bordi i ZRRE-së konstaton se ka mos përputhje në mes të gjeturave në fillim, si dhe konstatimit të fundit. Po ashtu në procesverbal është evidentuar se njehsori mbetet i kyçur në rrjetin e elektrik e që kjo është në kundërshtim me Rregullën për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji pasi që ekipet e KEDS-it është dashur të marrin menjëherë të gjitha masat me qëllim që konsumatorit t'i bëhet regjistrimi i saktë i energjisë së shpenzuar.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar edhe Protokollin mbi shqyrtimin e njehsorit elektrik nr. 0000260 i datës 05.05.2014 si dhe Procesverbalin e kontrollimit detal të njehsorit elektrik nr. 42/16 datë 16.05.2014. dhe se bazuar në të dhënat e evidentuara në dy procesverbalet konstaton se është bërë gabimi në përshkrimin e mos matjeve të fazave pasi që në procesverbalin nr. 0000260 vërtetohet se faza R ka gabim në matje, kurse "S" dhe "T" nuk bëjnë matje fare.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar korrigjimin plotësues të bërë nga Departamenti i faturimit në KESCO dhe konstaton se KESCO korrigjimin plotësues e ka bërë duke pasur për bazë me nenin 4.11.1 të Kodit të Matjes së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, ku thuhet se: "Pavarësisht a është gabimi në plus ose minus dhe tejkalon vlerën 3 herë e klasës së saktësisë (p.sh. për njehsorët e drejtpërdrejtë klasa e saktësisë është 2.0, kufiri i lejuar do të ishte 6.0%), atëherë bëhet ri-llogaritja e energjisë dhe përmirësimi i faturimit për 12 (dymbëdhjetë) muajt e fundit përkatësisht 6 muajt e fundit për konsumatorët shtëpiak. Por që ZRRE duke pasur parasysh se të gjeturat e evidentuara në procesverbalin e inspektimit nr. 0491189 të datës 27.11.2013 janë në kundërshtim mes veti përkatësisht pasqyrojnë dy gjendje, ku në rastin e parë është evidentuar se njehsori është në rregull, kurse në rastin e dytë fazat theksohet se "L2" dhe "L3" nuk kanë bërë matje dhe se daljet e njëjta janë të shkyçura, si dhe "L1" mbetet e kyçur. Lidhur me këtë Bordi i ZRRE-së konsideron se KESCO dhe KEDS nuk kanë arritur të argumentojnë konstatimin e tyre se njehsori elektrik nuk ka bërë matje të saktë, andaj konsideron se konsumatori duhet të shkarkohet nga korrigjimi plotësues.

Sipas nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji theksohet: "konsumatorët kanë obligimin që të paguajnë për energjinë e shfrytëzuar, sipas kontratës për Furnizim me Energji të lidhur me Furnizuesin e Energjisë, si dhe për tarifën për shfrytëzim të sistemit të miratuara nga ZRRE-ja". Bazuar në këtë dispozitë ligjore është konstatuar se në rastin konkret konsumatori ka obligim që të paguaj për atë që ka shpenzuar, por që jo të ngarkohet pa bazë për rastet që kanë probleme teknike në njehsorin elektrik

Bordi i ZRRE gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk



është vendim i drejt dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 29.03.2018 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

**III.** Vendimi nxirret në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

**IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

#### **Bordi i Rregullatorit:**

\_\_\_\_\_  
Arsim Janova, u.d. kryesues

\_\_\_\_\_  
Besim Sejfiqaj, anëtar

\_\_\_\_\_  
Selman Hoti, anëtar

\_\_\_\_\_  
Izet Rushiti, anëtar

#### **Vendimi iu dërgohet:**

- KESCO-së, dhe
- Konsumatorit J.K dhe,
- Arkivit të ZRRE-së